REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 423/25 Dt. 15.07.2025

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Zyrës për Komunitete dhe Kthim, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Derya Kala, Idbalka Rama Fazlija dhe Asim Imeri, zyrtarë për komunitete dhe kthim në ZKK të Komunës së Prizrenit, për në Serbi, me qëllim të vlerësimit të gjendjes faktike të të zhvendosurve nga Prizreni në Serbi. Udhëtimi-vizita, do të realizohet nga data 16 korrik 2025 deri me 18 korrik 2025, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, mbulimi i shpenzimeve të ushqimit, të akomodimit, të transportit dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

2. Për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar me makinë zyrtare të Komunës së Prizrenit.

3. Shuma e lejuar, e përshkruar në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Zyrës për Komunitete dhe Kthim,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurve,
- Arkivës së Kryetarit.